

Kryeministri i Serbisë, Aleksandar Vučić organizoi një pritje ceremoniale për kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, me nderime të larta shtetërore para Pallatit "Srbija" në Beogradin e Ri, i cili sot mbërriti në Serbi për vizitën dy-ditore, raporton Anadolu Agency (AA).

Kryeministrat e të dy vendeve do të zhvillojnë takimin "kokë më kokë", takim prej 20 minutash, pas së cilit në takimin plenar do të bisedojnë delegacionet e Serbisë dhe Shqipërisë.

Janë parashikuar gjithashtu të nënshkruhen disa marrëveshje, të dy kryeministrat më pas do t'ju drejtohen medieve, në një konferencë të përbashkët.

Vizita e Ramës e cila ishte planifikuar për 22 tetor u shty për shkak të incidenteve në ndeshjen e futbollit ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë. Të dy kryeministrat u dakorduan që vizita të shtyhet për 10 nëntor.

Edi Rama në Serbi do të qëndrojë për dy ditë. Të martën, ai do të vizitojë Luginën e Preshevës, është konfirmuar për Anadolu Agency nga Ambasada e Shqipërisë në Beograd.

Pas më shumë se shtatë dekadave, vizita e Edi Ramës do të jetë vizita e parë e një zyrtari të lartë shqiptar në Beograd. Herën e fundit kryeqytetin e ish-Jugosllavisë në vitin 1947, e vizitoi udhëheqësi komunist shqiptar Enver Hoxha ku u takua me Josip Broz Titon.

Në këtë kontekst Rama në një intervistë për AA marrëdhëniet Shqipëri-Serbi i shikon në perspektivën e një kohë të re për Ballkanin dhe nga ana tjetër sipas tij kjo kohë e re kërkon lidhshmëri, kërkon një qasje të re dhe të bashkuar, për një të ardhme që duhet të jetë më e mirë për të gjithë popujt e rajonit, duke lënë pas të gjitha ato që në të shkuarën, jo vetëm na kanë penguar të shkojmë përpara, por kanë shkaktuar shumë konflikte dhe kanë sjellë shumë gjakderdhje, të cilat duhet të ja lëmë historisë, për të shkruar së bashku një histori paqeje dhe bashkëpunimi rajonal.